

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në bazë të nenit 101 nga Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nenit 37 paragrafi (1), nënpika 1 dhe 3 nga Ligji për gjykatat (“Gazeta Zyrtare e RM” nr. 58/06...198/18 dhe “Gazeta Zyrtare e RMV” nr.96/19), neni 63, 65 dhe 66 nga Rregullorja e punës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në Seancën e përgjithshme të mbajtur më 21.12.2022, miratoi këtë:

QËNDRIM PARIMOR

Gjykatat, vendimet (aktgjykimet dhe aktvendimet) e miratuara që nuk janë të plotfuqishme dhe që kanë të bëjnë me lëndët me interes publik t’i publikojnë në web faqen e gjykatës.

A r s y e t i m

Sipas nenit 99 paragrafi (5) nga Ligji për gjykatat (“Gazeta Zyrtare e RM” nr. 58/06...198/18 dhe “Gazeta Zyrtare e RMV” nr.96/19), vendimet e plotfuqishme të miratuara gjykatat detyrimisht t’i publikojnë në web faqen e gjykatës në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë, në mënyrë të përcaktuar me Ligj.

Sipas nenit 9 paragrafi (1) nga Ligji për udhëheqje me qarkullimin e lëndëve në gjykatat (“Gazeta Zyrtare e RMV” nr.42/2019) nëpunësi gjyqësor i autorizuar i gjykatës së shkallës së parë detyrohet që në afat prej shtatë ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së vendimit gjyqësor, përkatësisht nga dita e dorëzimit të vendimit nga gjykata më e lartë, ta publikojë në web faqen e gjykatës me emrin dhe mbiemrin e palëve, përkatësisht emërtimin e personit juridik, në mënyrë që bëhet anonime adresa e vendbanimit, përkatësisht vendqëndrimit ose selisë së palëve, numri unik amë i qytetarit ose numri amë i subjektit të regjistrimit dhe të dhënat personale të dëshmitarëve dhe të dëmtuarve në procedurë.

Sipas nenit 125 paragrafi (3) të Ligjit për procedurë penale gjykatat obligohen që vendimet e miratuara në afat prej dy ditësh nga përgatitja t’i publikojnë në web faqen e gjykatës, në mënyrë të përcaktuar me ligj.

Sipas nenit 126 paragrafi (1) dhe (2) nga i njëjti ligj, të gjitha aktgjykimet gjyqësore janë publike dhe të arritshme në ekzemplare elektronike ose të shtypur, përveç në rastet kur publiku është i përjashtuar në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, këtë ligj dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë. Vendimet tjera gjyqësore janë të arritshme për shikim dhe përshkrim për çdo person të interesuar, përveç në raste kur publiku është i përjashtuar në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni.

Duke u nisur nga përmbajtja e dispozitave të theksuara nga Ligji për gjykatat, Ligji për udhëheqje me qarkullimin e lëndëve në gjykatat, pa diskutim rezulton se obligimi ligjor i gjykatave është që vendimet e plotfuqishme të miratuara në afat të caktuar t'i publikojnë në web faqen e gjykatës për dallim nga neni 126 paragrafi (1) dhe (2) të Ligjit për procedurë penale, sipas të cilit nen të gjitha vendimet gjyqësore janë publike dhe të arritshme në ekzemplare elektronike ose të shtypur, të arritshme për shikim dhe përshkrim për çdo person të interesuar.

Duke qenë se Ligji për procedurë penale si ligj sistemor që paraqet ligjin special në raport me Ligjin për gjykatat dhe Ligjin për udhëheqje me qarkullimin e lëndëve në gjykatat, duke u nisur nga rregulli „lex specialis derogate lex generalis“, në rastin konkret, lidhur me publikimin e vendimeve (aktgjykimeve dhe aktvendimeve) gjyqësore në web faqen e gjykatës, është e pashmangshme që të gjitha vendimet gjyqësore të publikohen në web faqen e gjykatës.

Publiciteti i procedurave gjyqësore është një parim i garantuar me kushtetutë sipas nenit 102 nga Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë. Në nenin 16 nga Kushtetuta garantohet liria e informimit publik.

Sipas nenit 6 nga Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut aktgjykimi kumtohet publikisht, ndërsa sipas nenit 10 çdo njeri ka të drejtën e shprehjes së lirë dhe kjo e drejtë i përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë e pranimi dhe bartjes së informacioneve.

Në drejtim të parimit të publicitetit, praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut tregon rëndësinë e veçantë të qasjes së aktgjykimit për publikun më gjerë dhe dukshmërinë në realizimin e drejtësisë (Sutter v. Switzerland); se qasja publike duhet të vlerësohet si zbardhje e karakteristikave të veçanta të procedurës në fjalë dhe në drejtim të nenit 6 nga Konventa (P and B v. United Kingdom); dhe se kur institucionet shtetërore dhe gjykatat mbajnë informacione me karakter të lartë publik, refuzimi i qasjes në ato të dhëna për qytetarët ose organizatat të cilët kërkojnë qasjen në to, është shkelje e të drejtës së lirisë së shprehjes dhe informimit e garantuar sipas nenit 10 nga Konventa (Tbrsasbg a Szabadybgjogokirt v. Hungary).

Në këtë kuptim, njoftimi për mbajtjen e seancave gjyqësore, miratimi i vendimit dhe detaje plotësuese nga lënda, gjykata nacionale duhet të sigurojë dukshmërinë për publikun, respektivisht ai të jetë i njoftuar me këto informacione.

Rekomandimi Rec (2003) 13 të Këshillit të Evropës për sigurimin e informacioneve përmes medimeve lidhur me procedurën penale tregon të drejtën e publikut të marrë informacione me karakter të përgjithshëm, si dhe nevojat e gazetarëve për qasjen në informacione të domosdoshme që të mund të njoftojnë për funksionimin e sistemit gjyqësor.

Gazetarëve dhe medimeve që kanë interes publik dhe juridik në një procedurë të caktuar penale, gjykata doemos duhet të ju sigurojë qasjen në vendimet gjyqësore, me qëllim që të njëjtat të mund të përdoren për qëllime të informimit korrekt në publik,

respektivisht tërë kjo mbështetet me praktikën gjyqësore të GJEDNJ në cekjen e kuptimit të prioritetit të interesit publik.

Për shkak të sipër theksuarës, Kryetarja e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut për atë se cila gjykatë është përgjegjëse për barazinë në zbatimin e ligjeve nga gjykatat dhe për punën e gjykatave, sipas nenit 37 paragrafi (1) nënpika 1 dhe 3 të Ligjit për gjykatat, propozoi që Seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut të miratojë qëndrimin parimor që gjykatat, vendimet (aktgjykimet dhe aktvendimet) e miratuara të cilat nuk janë të plotfuqishme dhe të cilat kanë të bëjnë me lëndët me interes publik t'i publikojnë në web faqen e gjykatës.

Seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, të mbajtur më 21.12.2022, pas diskutimit për propozim qëndrimin parimor, sipas nenit 37 paragrafi (1) nënpika 1 dhe 3 të Ligjit për gjykatat, miratoi qëndrimin e propozuar parimor.

**GJYKATA SUPREME E
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT
SEANCA E PËRGJITHSHME**